



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV Syri Vision
Enver MULLIQI
Drejtor
Gjakovë

Ankesa Nr. 2015/186 KPM vs TV Syri Vision
Ref:1602/221/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2015/186 – Komisioni i Pavarur i Media (KPM) kundër TV Syri Vision (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 12 mars 2010. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës, obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së, dhe me te gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM), datën 28 maj 2013, ka miratuar Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-vizuale KPM-2013/03, e cila ka hyrë në fuqi më 28 gusht 2013. Me Rregulloren KPM-2013/03 janë përcaktuar parimet themelore të përmbajtjes së komunikimit komercial audiovizual, sasia e komunikimit komercial audiovizual të transmetuar nga shërbyesit audiovizual duke përfshirë edhe teleshoppingn dhe sponsorimet për programet e radios dhe televizionit
3. KPM ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM-2013/03. KPM bazuar në raportin e monitorimit të datës 30 shtator 2015, ka gjetur se gjatë kësaj periudhe Pala Përgjegjëse, ka bërë shkelje të Rregullores KPM-2013/03, përkatësisht nenit 10, paragrafi 1, dhe paragrafi 2.3.
4. KPM bazuar në shkeljen e Rregullores KPM-2013/03 nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 2 tetor 2015, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin nga Pala Përgjegjësen është kërkuar që të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/03, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.

5. KPM, me datën 5 tetor 2015, ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, me pretendimin se pas pranimit të Njoftimit për Shkelje të datës 2 tetor 2015, ka bërë kontrollin e bllokut të marketingut dhe se sipas tyre nuk kanë bërë shkelje të nenit 10 paragrafi 1 dhe 2.3.
6. KPM, edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, serish me datën 20 tetor 2015, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM-2013/03. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse, edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të datës 25 tetor 2015, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/03, për shkak të mos paralajmërimit të blloqeve reklamuese, duke mos bërë ndarjen e pjesës tjetër programore nga reklamimi, si dhe transmetim të teleshopingut pa paralajmërim, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 1, dhe nenin 10, paragrafi 1, dhe 2.3, të Rregullores KPM-2013/03.

Analiza Ligjore

7. Komisioni i KPM-së bazuara në faktet e lartpërmendura, konkludon se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2.3 dhe nenit 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/03.

Neni 10, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2013/03 përcakton se:

“Kohëzgjatja e reklamimit televiziv dhe teleshopingut (përfshirë reklamimin me ekran të ndarë dhe tele-promocionin) për transmetuesit televiziv komercial nuk duhet të kalojë dymbëdhjetë (12) minuta për orë, me përjashtim të dritareve të teleshopingut.”

Neni 10, paragrafi 2.3 i Rregullores KPM-2013/03 përcakton se:

“Dritaret e teleshopingut duhet të identifikohen qartazi si të tilla me mjete pamore e dëgjimore në fillim dhe në fund të dritareve dhe duhet të jenë me kohëzgjatje minimale të pandërprerë prej 15 minutash. Numri maksimal i numrit të dritareve për ditë duhet të jetë 6. Kohëzgjatja e tyre e përgjithshme nuk duhet të tejkalojë 90 minuta brenda 24 orëve.”

Neni 9, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2013/03 përcakton se:

“Reklamimi televiziv dhe teleshopingu duhet të jenë lehtësisht të dallueshme dhe të veçueshme nga përmbajtja editoriale. Pa paragjykim ndaj shfrytëzimit të teknikave të reja të reklamimit, reklamimi televiziv dhe teleshopingu duhet të mbahen bukur të dallueshme nga pjesët tjera të programit me anë të mjeteve pamore apo/edhe dëgjimore dhe/ose hapësinore.”

8. Komisioni i KPM-së duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshme për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2.3, dhe nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/03.

9. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse, edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/03, për shkak të mos paralajmërimit të blloqeve reklamuese, duke mos bërë ndarjen e pjesës tjetër programore nga reklamimi, nenin 10, paragrafi 1, tejkalimi i minutazhit të lejuar prej 12 minutash për transmetimin e komunikimeve komerciale brenda një ore transmetim si dhe paragrafin 2.3 të nenit 10, transmetimi i teleshopingut në kohëzgjatje me të shkurtër se 15 minuta.
10. KPM ka vazhduar me monitorim e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2.3 dhe nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/03, dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të respektimit të Rregullores KPM-2013/03, prandaj Komisioni si rrethanë rënduese për Palën Përgjegjëse merr shkeljen e vazhdueshme të Rregullores KPM-2013/03 edhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/03.
11. Komisioni i KPM-së, duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2.3, dhe nenit 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/03.

Vendimi

12. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konkludon se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2.3, dhe nenit 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/03.
13. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së sanksionon me Vërejtje Pala Përgjegjëse për shkeljet të vazhdueshme të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2.3, dhe nenit 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/03.
14. Pala Përgjegjëse obligohet që të respektojë Rregulloren KPM-2013/03, duke e respektuar minutazhin e lejuar prej 12 minutash për transmetimin e komunikimeve komerciale brenda një ore transmetim, të paralajmëroj transmetimin e teleshopingut si dhe dritaret e tepeshopingu duhet të jenë me kohëzgjatje minimale të pandërprerë prej 15 minutash. Dështimi i Palës Përgjegjëse që edhe pas kësaj Vërejtjeje të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/03, do të rezultojë me masa tjera ligjore, në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.


E drejta për Ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së,

apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



11 shkurt 2016

datë

221

Lloji i dërgesës
Vrsta poşiljke

Vlera e cekur - Shuma e dërguar
Oznaçona vrednost - poslani iznos

nën numër
pod broj

për
za


TV SYRI VISION / ENVER MULLIQI
PR/ KOLË HLESHI NR/28 GP/AROVË

(Vendi)
(Mesto)

Poshtë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma
e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë)
Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka
(poslani iznos) predana uredno (placena dana)

01.03.2016

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca



Vula e postës së vendit
Peçat pošte



Nënshkrimi i nënpunësit
të postës së vendit
Potpis radnika pošte

